



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo - Republika Kosovo
Qeveria- Government -Vlada

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra për Planifikim Strategjik
Kancelarija za Strateško Planiranje – Strategic Planning Office

RAPORTI I ZBATIMIT TË PROGRAMIT PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2022-2027 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2022-2024

Periudha e raportimit: 2022-2024

Mars 2025

Përmbajtje

Hyrje	3
Qasja strategjike dhe qëndrueshmëria	5
Parandalimi	8
Koncept dokumentet	8
Legjislacioni	8
Aktet ligjore.....	9
2023	9
2024	10
Treguesi për BE në Agjendën e Reformave të Kosovës (Plani i Rritjes).....	10
Projektligjet e shqyrtuara gjatë vitit 2024 në pritje të miratimit nga Qeveria	11
Aktet nënligjore	11
Zvogëlimi	13
Thjeshtimi i shërbimeve në nivel qendror	13
Thjeshtimi i shërbimeve në nivel lokal	14
Digjitalizimi i shërbimeve.....	15
5 Bashkëpunimi.....	18
SHTOJCA 1: Lista e Koncept Dokumenteve relevante për barrë administrative të shqyrtuara para miratimit në Qeveri për vitin 2024.....	20
SHTOJCA 2: Lista e akteve ligjore të shqyrtuara para miratimit në Qeveri në kontekst të parandalimit të barrës administrative për vitin 2023	23
SHTOJCA 3: Lista e akteve ligjore të shqyrtuara para miratimit në Qeveri në kontekst të parandalimit të barrës administrative për vitin 2024	26
SHTOJCA 4: Tabela raportuese për treguesin mbi barrën administrative në Agjendën e Reformave të Kosovës (Plani i Rritjes)	40
SHTOJCA 5: Ligjet të shqyrtuara në kontekst të barrës administrative në proces apo në pritje të miratimit 2024	54
SHTOJCA 6: Lista e akteve nënligjore të shqyrtuara apo hartuara para miratimit në Qeveri në kontekst të parandalimit të barrës administrative për vitin 2023-2024.....	57

Hyrje

Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 dhe Plani i Veprimit 2022-2024 (tash e tutje Programi), është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (tash e tutje Qeveria) me datën 14 shtator 2022. Nën mbikëqyrjen e Zëvendëskryeministrit të Parë dhe nën udhëheqjen dhe koordinimin e Zyrës për Planifikim Strategjik (tash e tutje ZPS) të Zyrës së Kryeministrit (tash e tutje ZKM), të gjitha objektivat strategjike dhe specifike sipas planit të veprimit për zbatimin e Programit kanë shënuar **progres të avancuar**, i theksuar edhe nga **raportet ndërkombëtare**.

Duke marrë për bazë që Programi është zhvilluar në atë formë që të jetë një **dokument fleksibil që ndryshon për procesin dhe nga procesi**, një numër i aktiviteteve ndonëse nuk janë të theksuara në mënyrë specifike në Planin e Veprimit (tash e tutje PV), zbatimi i tyre është mbështetur në kuadër të programit ngase ndërlidhen me aktivitetet të theksuara në Plan, dhe me qasjen e Programit.

Po ashtu, arritja e rezultateve të shprehura në Raport, është bërë fillimisht nga mbështetja e madhe politike dhe prioritizimi i procesit nga Zëvendëskryeministri i Parë dhe Kabineti i tij, mbështetja, bashkëpunimi dhe komunikimi i mirë nga Ministritë të linjës dhe agjencive relevante, bashkëpunimi dhe avokimi i organizatave të shoqërisë civile dhe odave të biznesit, si dhe me mbështetjen e madhe të partnerëve zhvillimorë.

Disa prej vlerësimeve kryesore ndërkombëtare të këtyre 2 viteve zbatim, janë si në vijim:

- *Raporti për Vendin 2024 e thekson zbatimin e Programit si progres i avancuar, si një prej arritjeve kryesore në fushën e administratës publike, si “Kosova ka avancuar në zvogëlimin e barrës administrative me anë të thjeshtimit të procedurave nëpërmjet zbatimit të Programit 2022-2024”.¹*
- *Raporti i Monitorimit të OECD/SIGMA 2024, ka vlerësuar procesin e BA, duke theksuar se “politika mbi thjeshtimin administrativ, zvogëlimin dhe parandalimin e barrës administrative ka pasur një progres të konsiderueshëm. Për këtë, dy treguesit kryesor për BA, janë vlerësuar të arritur 100%, konkretisht treguesi 19.4 për Zvogëlimin e Barrës Administrative, ku prej 15 pikëve janë arritur 15 pikë, apo 100% dhe treguesit 6.1 për Aplikimin e Masave për Thjeshtimin Administrative, ku prej 20 pikëve janë arritur 20, apo 100%. Duhet theksuar se raporti i vitit 2021, e kishte vlerësuar këtë proces me vetëm 0.6 pikë nga 6 në total.”²*

Disa prej arritjeve kryesore gjatë këtyre dy viteve zbatim, janë si në vijim:

- *Krijimi i qëndrueshmërisë për proces, duke përfshirë mbi 60 zyrtarë që në baza javore merren me barrën administrative;*
- *Trajnimi i 500 zyrtarëve në nivel qendror dhe lokal;*
- *Thjeshtimi i 115 shërbimeve në nivel qendror;*
- *Thjeshtimi i mbi 600 shërbimeve në nivel lokal në 22 komuna;*
- *Analizimi i mbi 200 shërbimeve në nivel qendror, të gatshme për thjeshtim;*
- *Digjitalizimi dhe inicimi i digjitalizimit për më shumë se 100 shërbimeve në nivel qendror;*

¹ Shih https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2024_en, fq. 4.

² Shih https://www.sigmaweb.org/en/publications/public-administration-in-kosovo-2024_a53fce6b-en.html

➤ *Kursimi i mbi 3.5 milion eurove për qytetarë dhe biznese pas thjeshtimeve.*

Arritjet e theksuara në këtë raport do të ishte i mangët pa mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe Gjermanisë, nëpërmjet projektit të bashkë-financuar për zvogëlimin e barrës administrative, si pjesë e modulit “Mbështetje e Reformave për Integrim Evropian në Kosovë”, i zbatuar nga GlZ, si dhe pa mbështetjen e Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO) të Qeverisë Zvicerane, nëpërmjet projektit “Përshpejtimi i klimës së investimeve”, i zbatuar nga Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC).

Palët e interesuara, mund të kërkojnë të gjitha dëshmitë për të arriturat e paraqitura në këtë Raport, në **Zyrën për Planifikim Strategjik të Zyrës së Kryeministrit.**

Qasja strategjike dhe qëndrueshmëria

Zbatimi i Programit për vitin 2022-2023 është shoqëruar me aspekte kryesore, të cilat janë thelbësore për arritjen e rezultateve në zbatim.

Organizimi i punës sipas këtyre aspekteve të cilat janë të pandashme dhe njëkohësisht **krijojnë sinergji**, ka ndikuar në ngritjen e **vëmendjes së zyrtarëve publikë**, shoqërisë civile dhe odave të biznesit mbi rëndësinë dhe kujdesin që duhet t'i jepet barrës administrative për qytetarë dhe biznese. Po ashtu, kjo qasje ka plotësuar edhe procese tjera të digjitalizimit me qëllim përmirësimin e shërbimeve, të paraqitura në Strategjinë për Reformën e Administratës Publike dhe Strategjinë për Qeverisje Elektronike, të miratuara nga Qeveria.

Duke marrë për bazë analizimin e gjendjes aktuale në këtë fushë, të fokusuar në kornizën për zhvillimin e politikave publike (strategji, koncept dokumente dhe legjislacion), burimet njerëzore (politikëbërëse, ligjore, teknologjike) dhe kulturën administrative të administratës publike në vend, qasja strategjike për zbatimin e Programit është zhvilluar në atë mënyrë që t'i përshtatet kësaj gjendjeje të analizuar.

Disa prej aspekteve kyçe të kësaj qasjeje (të cilat janë të shprehura në Program, mirëpo disa janë edhe të zhvilluara gjatë procesit të zbatimit) janë si në vijim:

➤ *Planifikimi dhe pronësia e procesit*

Për një zbatim të suksesshëm të Programit, është **centralizuar planifikimi dhe koordinimi** dhe është **decentralizuar pronësia dhe zbatimi**. Në këtë mënyrë, ministritë kanë marrë të gatshme planet dhe mbështetjen me ekspertizë **nga qendra** (prej idesë deri te mbështetja për hartimin apo ndryshimin e politikave dhe legjislacionit, deri te zhvillimi i sistemeve dhe mirëmbajtja e tyre për periudhë dy vjeçare), ndërsa kanë **udhëhequr dhe kanë pronësinë** e reformës në proces duke i dizajnuar shërbimet në atë mënyrë që mundësojnë zvogëlimin e barrës për qytetarë dhe biznese, por edhe për zvogëlimin e kostos së ofrimit të shërbimeve nga institucionet përkatëse.

➤ *Thjeshtim dhe digjitalizim në të njëjtën kohë*

Qasja e re strategjike është zhvilluar në atë drejtim që **thjeshtimi dhe digjitalizimi** të bëhen në **të njëjtën kohë**. Duhet theksuar se, sipas praktikave të vendeve tjera, zakonisht është bërë thjeshtimi pastaj digjitalizimi, mirëpo qasja e re strategjike e Programit, ka marrë rrugë drejt thjeshtimit dhe digjitalizimit në të njëjtën kohë, **duke nxitur digjitalizimin si motivues për thjeshtim**. Kjo vjen si rezultat i gjendjes aktuale në administratën publike, e cila karakterizohet nga vonesa në ndryshim të legjislacionit dhe nga **kultura administrative e vjetruar**.

➤ *Kombinimi i temave dhe zyrtarëve*

Duke marrë për bazë kulturën administrative të administratës publike, si shpesh të izoluar në trajnimin e proceseve të ndryshme që dërgojnë në një rezultat të vetëm (shërbimi për qytetarë dhe biznese) qasja e re strategjike po ashtu është zhvilluar në drejtim **të kombinimit të temave dhe zyrtarëve** publikë për çështjen e njëjtë. Në këtë aspekt, grupet punuese, trajnimet, forumet apo ngjarjet e ndryshme janë organizuar në atë mënyrë që zyrtarët që hartojnë politika publike, zyrtarët ligjorë dhe zyrtarët për teknologji informative **janë bërë bashkë**, si për marrjen e trajnimit për procesin e barrës administrative, ashtu edhe gjatë procesit, për diskutimin dhe zbatimin e aktiviteteve për arritjen e rezultateve të njëjta.

➤ *Bashkëpunimi: nga avokimi në zbatim*

Zakonisht në vendet tjera, disa prej analizave, matjeve apo identifikimit të metodologjive dhe ideve, bëhen nëpërmjet bashkëpunimit të Qeverisë me universitetet. Duke marrë për bazë mungesën e kapaciteteve në administratën publike, për disa prej aspekteve të rëndësishme për zbatimin e Programit, siç janë analizat, matjet dhe identifikimi i metodologjive dhe praktikave të mira, qasja e re ka përfshirë po ashtu bashkëpunimin për zbatim me organizatat e shoqërisë civile dhe odat e biznesit në mënyrë që procesi të avancojë **nga bashkëpunimi për avokim në bashkëpunimin për zbatim**. Në këtë kontekst, disa prej analizave, matjeve apo mbikëqyrjeve si aktivitete të Programit, janë zbatuar më mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile apo odave të biznesit.

➤ *Ngritja e vëmendjes brenda administratës*

Ngritja e vëmendjes për barrën administrative brenda administratës është një prej aspekteve më të rëndësishme të qasjes së Programit. Kjo është duke u bërë nëpërmjet trajnimeve, dizajnit dhe punës së përbashkët dhe grupeve punuese apo forumeve të përbashkëta. Siç u theksua më lartë dhe siç do të detajohet më poshtë në Raport, moduli i ri trajnues ka rezultuar që shërben edhe për ngritje të vëmendjes për procesin e barrës administrative dhe për të mirat në punë që kanë zyrtarët në rast se parandalojnë apo zvogëlojnë barrë dhe nëse digjitalizojnë procese. Po ashtu, një prej metodave për vëmendje është **procesi i dizajnit të përbashkët të shërbimeve apo mendimit kreativ**, ku zyrtarët sipas grupeve dhe profileve të ndryshme, mësojnë, diskutojnë dhe krijojnë prototipe të shërbimeve duke pasur përdoruesin në qendër dhe duke dizajnuar në atë mënyrë që lehtëson punën e tyre gjatë procesit.

Një nga aspektet kryesore për zbatimin e Programit është **sigurimi i qëndrueshmërisë**. Ky aspekt është i nevojshëm dhe kyç për ndikimin në kulturën administrative në zhvillimin dhe dizajnimin e politikave publike (strategji, koncept dokumente dhe legjislacion) për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarë dhe biznese, me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit të barrës administrative.

Në kontekst të sigurimit të qëndrueshmërisë, për zbatimin e Programit, janë marrë masa në katër drejtime, si *mekanizmat, mjetet, analizat dhe trajnimet*.

Themelimi apo funksionalizimi i mekanizmave për zbatimin e Programit është fokusuar në dy nivele: **politik dhe operativ** (qendror dhe lokal). Sa i përket nivelit politik, sikurse theksohet në Program, është mbledhur dy herë brenda vitit **Komisioni për Planifikim Strategjik** (tash e tutje KPS), i kryesuar nga Kryeministri. Në kuadër të këtij komisioni, si përgjegjës politik mbi procesin e barrës administrative ishte ZVKM, ndërsa si anëtar të KPS ishin ministrat përkatës vëmendja e të cilëve ishte e nevojshme për të shtyrë zbatimin e Programit. Po ashtu, KPS përbëhet edhe nga Sekretaria operative e cila mbulohet nga ZPS e ZKM.

Në kuadër të nivelit operativ, themelimi i mekanizmave është fokusuar në tri nivele: ZKM, institucione qendrore dhe komuna, ku është bërë:

1. *Emërimi i Koordinatorit të Procesit të Barrës Administrative me vendim të Qeverisë*
2. *Emërimi i 20 zyrtarëve përgjegjës në nivel qendror për procesin e barrës administrative me vendim të Sekretarëve të Përgjithshëm*
3. *Emërimi i 32 zyrtarëve përgjegjës në nivel lokal për procesin e barrës administrative me vendim të Kryetarëve të Komunave*
4. *Organizimi i 3 takimeve të Komisionit për Planifikim Strategjik.*

Zhvillimi, hartimi apo përmirësimi i mjeteve, analizave, metodologjive dhe planve të ndryshme që e bënë të mundshme zbatimin e Programit, të cilat **mundësuan zbatimin e Programit**, janë:

1. Analiza për përditësimin e udhëzuesit për zhvillimin e memorandumeve shpjeguese
2. Hartimi i udhëzuesit të ri për hartimin e memorandumeve shpjeguese
3. Zhvillimi i metodologjisë për zbatimin e parimit të personalizim në thjeshtim dhe digjitalizim të shërbimeve
4. Zhvillimi i udhëzuesit për Modelin e Kostimit Standard dhe Mbulimin e Kostos dhe Skedarëve Excel
5. Zhvillimi elektronik i Skedarëve Excel të Modelit të Kostimit Standard dhe tq Mbulimit të Kostos.
6. Zhvillimi i testit filtrues për politikat publike

Trajnimi i zyrtarëve publikë të nivelit qendror dhe lokal ka filluar nga muaji shtator 2023, pas zhvillimit të modulit të ri, materialeve shoqëruese dhe testeve të vlerësimit në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (tash e tutje IKAP). Në modulën e ri, si u theksua shkurtimisht më lartë, është ndjekur **qasja e kombinuar**, përfshirë komponentët kryesor për parandalimin dhe zvogëlimin e barrës administrative: modeli i kostimit standard (tash e tutje MKS), vlerësimi i ndikimit rregullator (koncept dokumentet), parimet e procedurave të përgjithshme administrative që lidhen ngushtë me barrën administrative, hartimi ligjor dhe dizajnimin kreativ të shërbimeve, koncepti i ri i inicuar në administratë publike. Këta komponentë janë të shoqëruara me pjesë konceptuale, si definimi i barrës administrative dhe digjitalizimi në funksion të barrës administrative apo zhvillimi i politikave publike që mundësojnë digjitalizimin.

Aktivitetet të cilat janë përfunduar në funksion të ngritjes së vetëdijes së zyrtarëve publikë përmes trajnimeve, janë si në vijim:

1. Analiza e detajuar e trajnimeve që ofrohen në IKAP në kontekst të barrës administrative dhe identifikimi i nevojave dhe profileve për trajnim për barrë administrative
2. Përgatitja e profileve dhe listës së zyrtarëve për pjesëmarrje në trajnime
3. Përgatitja e materialit trajnues, përfshirë manualin, prezantimet, ushtrimet dhe testet e trajnimit, sipas Programit.
4. Organizimi i trajnimeve për zyrtarët publikë të nivelit qendror dhe lokal
5. Përgatitja e konceptit për trajnime për TIK në politik- bërje të bazuara në barazi gjinore
6. Përgatitja e modulit për trajnime për TIK në politik-bërje të bazuara në barazi gjinore
7. Përgatitja e materialeve, testeve dhe shembujve për trajnimin online nëpërmjet platformës moodle.
8. Organizimi i DigiCamp 2023, DigiCamp 2024 dhe DigiCamp 2025, ku morën pjesë mbi 1000 pjesëmarrës.

Pjesëmarrja në trajnim ka qenë dhe është duke vijuar si **e kombinuar**, që nënkupton se zyrtarët me funksione të ndryshme janë duke e ndjekur trajnimin e njëjtë përnjëherë, ku janë duke u ndarë sfidat, problemet, pyetjet, mësimet dhe përvojat mes tyre. Kjo qasje e kombinuar ka rezultuar se motivon interaktivitetin, e cila bënë që trajnimi të jetë i dobishëm për krijimin e qëndrueshmërisë institucionale në funksion të parandalimit dhe zvogëlimin të barrës administrative. Kjo qasje, mes tjerash, është duke shërbyer edhe për ngritjen e vëmendjes së zyrtarëve publikë për procesin e barrës administrative. Trajnimet janë organizuar sipas prioritizimit institucional, **jo më shumë se dy trajnime në muaj dhe jo më pak se pesë ditë për trajnim**. Trajnimi është përcjellur me një **test të njohurive**, në fillim dhe në fund të trajnimit, për vlerësimin e ndikimit të trajnimit. Të dhënat mbi trajnimet në vitin 2022-2024 ishte sipas tabelës në vijim:

	Kanë kaluar	%	Nuk kanë kaluar	%	Totali
Testi 1	325	65	175	35	500
Testi 2	430	86	70	14	500

Parandalimi

Sigurimi i qëndrueshmërisë është aspekt kyç në parandalimin e barrës administrative në politika publike, qofshin ato koncept dokumente, ligje apo akte nënligjore. Qëndrueshmëria në proces motivon punën sistematike drejt arritjes së reformës së dëshiruar. Në këtë kontekst, Qeveria nëpërmjet ZPS të ZKM, ka ndërmarrë dhe përsëritur disa masa dhe aktivitete për parandalimin e barrës administrative, të cilat do të detajohen më poshtë:

1. Zhvillimi i listës kontrolluese në kontekst të parandalimit dhe zvogëlimit të barrës administrative përgjatë zhvillimit të koncept dokumenteve;
2. Kontrolli i vazhdueshëm i koncept dokumenteve në kontekst të barrës administrative;
3. Kontrolli i vazhdueshëm i legjislacionit në kontekst të barrës administrative;
4. Identifikimi i lejimeve kyçe për të cilat ka më shumë popullim dhe frekuencë prej grave dhe të rinjve;
5. Zhvillimi i pasaportës informative të biznesit.

Koncept dokumentet³

Duhet theksuar se parandalimi është shtrirë në dy nivele, në koncept dokumente dhe në akte ligjore dhe nënligjore. Për këtë aspekt, sa i përket shqyrtimit të koncept dokumenteve para miratimit të tyre në Qeveri, janë arritur rezultatet si në vijim:

Shqyrtimi			Adresimi i kontributit për BA ⁴			Niveli i adresimit të kontributit për BA në KD ⁵		
Totali i KD të shqyrtuara	35		Totali i komenteve të dhëna	149		I ulët	2	8%
Relevante për BA	14	43%	Komentet e adresuara	109	73%	Pjesor	4	23%
Jo relevante për BA	21	57%	Komentet e pa adresuara	40	27%	I plotë	10	69%

Legjislacioni

Duhet theksuar se shqyrtimi i të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore gjatë periudhës 2023-2024 është ndarë në relevante dhe jo relevante për barrën administrative. Kjo ndarje është bërë duke u bazuar në disa kritere, si në vijim:

1. Relevante janë cilësuar të gjitha ato akte ligjore apo nënligjore që përmbajnë shërbime apo rregullojnë ofrimin e tyre për qytetarë dhe biznese, si licenca, leje, regjistrime, pëlqime, autorizime, certifikime, etj., si dhe kur rregullohet shërbimi, si pritja, organizimi, mirëmbajtja, ndarje e përgjegjësi, dizajnimi i procedurës, themelimi i trupave, etj., që përmbajnë hapa procedural apo procese brenda për brenda procedure administrative.
2. Jo relevante janë cilësuar të gjitha ato që nuk i përmbajnë ato elemente të theksuara si më lartë.

Duhet theksuar po ashtu, se të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore janë shqyrtuar, komentuar apo hartuar në atë formë që të paktën të promovojnë digjitalizimin, nëse nuk e rregullojnë atë në tërësi. Për këtë është përdorur metodologjia e integruar në Program, konkretisht pjesa “1.4 Elementet” dhe “1.5 Metodologjia e përgjithshme për parandalim dhe zvogëlim të barrës administrative”, e cila është përdorur në proces dhe e cila është

³ Shih shtojcën 1. Në shtojcë janë ofruar vetëm të dhënat mbi koncept dokumentet relevante për barrën administrative.

⁴ Këto të dhëna janë vetëm për KD relevante për BA të matura pas miratimit në Qeveri.

⁵ Këto të dhëna të adresimit të matura vetëm për 13 KD të miratuara deri më 31 dhjetor 2024.

përditësuar dhe është bërë shtojca 2 e Programit të ri 2025-2028. Kjo listë ka gërshetuar parimet e procedurës së përgjithshme administrative me parimet për qeverisje elektronike.⁶

Pra, ZPS ka komentuar dhe ndihmuar hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore vetëm në aspekt të dizajnit të procedurave dhe shërbimeve dhe promovimin e digjitalizimit dhe jo në aspekte të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë, të cilat janë përgjegjësi e departamenteve ligjore.

Aktet ligjore

ZPS ka komentuar të gjitha ligjet të cilat kanë ardhur për komente dhe shqyrtim në fazën e konsultimit paraprak, dhe, në disa raste, ka mbajtur edhe takime me institucionet pronare të ligjeve, kur projektligjet ishin relevante për barrë administrative. Kur projektligjet nuk ishin relevante për barrën administrative, thjesht nuk është bërë ndonjë veprim drejt ministrive, por është evidentuar dhe vendosur në dosje të barrës administrative. Sidoqoftë, duhet theksuar se procesi i parandalimit të barrës administrative ka filluar në gjysmën e dytë të qershorit të vitit 2023. Deri në atë periudhë, një numër i lartë i ligjeve vetëm se ishin miratuar në Qeveri dhe dërguar në Kuvend, dhe ato u miratuan pa iu nënshtruar kontrollit për parandalim të barrës administrative, meqenëse ky proces ende nuk kishte filluar.

Sidoqoftë, për vitin 2024, kontrolli i ligjeve për parandalimin e barrës administrative është bërë sistematik.⁷ Përjashtuar dy ligje, të gjitha ligjet e miratuara në Qeveri u shqyrtuan për këtë qëllim. Këto dy ligje janë hartuar shumë më herët para se të fillojë procesi aktual.

Duhet theksuar se në vitin 2024, numri më i madh i ligjeve të cilat janë miratuar në Qeveri, nuk kanë qenë relevante për barrë administrative. Sidoqoftë, gjatë vitit 2024, ZPS ka shqyrtuar 19 projektligje të cilat janë në proces dhe ende nuk janë miratuar, 8 prej të cilave janë relevante për barrë administrative, 2 prej të cilave po mbështeten në hartim të plotë si pjesë e këtij procesi.

2023⁸

Të shqyrtuara para miratimit në Qeveri	Relevante për BA	Numri i komenteve të dhëna	Numri i komenteve adresuara	Të miratuara në Qeveri	Të miratuara në Kuvend	Numri i shërbimeve të thjeshtuara
7	4	40	15	7	3	5

Siç tregon tabela, në vitin 2023, janë shqyrtuar 7 ligje për parandalimin e barrës administrative. Të gjitha janë miratuar në Qeveri, ndërsa 3 prej tyre edhe në Kuvend. Prej 7 ligjeve të miratuara në Qeveri, 4 janë relevante për barrë administrative, të cilat janë komentuar në dispozitat e nevojshme. Janë dhënë 40 komente, prej të cilave janë adresuar 15 sosh. Si pasojë e kësaj, janë thjeshtuar 5 shërbime, mirëpo duhet të theksojmë se 3 sosh, presin ende miratimin në Kuvend, që thjeshtimi të jetë final.

⁶ Shih Programin 2022-2027 në linkun chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgclefindmkaj/https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/09/ZPS-shtator2022-PPZBA-2022-2027-dhe-PV-2022-2024-Shtojca-1-6-FINAL-ENG-1.pdf.

⁷ Shih GLPS, <https://legalpoliticalstudies.org/findings-from-the-monitoring-of-the-program-for-preventing-and-reducing-administrative-burdens-2023-2024/>, fq. 7.

⁸ Shih Shtojcën 2.

2024⁹

Të miratuara në Qeveri	Të shqyrtuara para miratimit në Qeveri	Relevante për BA	Numri i komenteve të dhëna	Numri i komenteve të adresuara	Të miratuara në Kuvend	Numri i shërbimeve të thjeshtuara
51	49	3	75	32	15	6

Siç tregon tabela, në vitin 2024 janë miratuar 51 ligje në Qeveri¹⁰, 15 prej të cilave edhe në Kuvend. Nga 51 të miratuara në Qeveri, 49 sosh janë shqyrtuar për parandalimin e barrës administrative. 2 ligjet të cilat nuk janë shqyrtuar për parandalimin e barrës administrative, janë relevante për barrën administrative, mirëpo hartimi i tyre është bërë shumë më herët dhe konsultimet publike për to kanë përfunduar në janar 2022, apo një vit e gjysmë më herët prej fillimit të procesit. Nga 49 ligje të shqyrtuara, 3 ishin relevante për barrën administrative, për të cilat janë dhënë 75 komente të nevojshme në dispozitat ligjore, prej të cilave 32 sosh janë adresuar nga institucionet, që ka rezultuar në parandalimin dhe thjeshtimin e 6 shërbimeve. Duhet theksuar se të gjitha këto presin miratimin edhe në Kuvend, që thjeshtimi të jetë final.

Treguesi për BE në Agjendën e Reformave të Kosovës (Plani i Rritjes)¹¹

Në kuadër të Agjendës së Reformave të Kosovës, i njohur ndryshe edhe si Plani i Rritjes, Qeveria e Kosovës ka negociuar treguesin *2.1.1.1 100% e ligjeve të reja që përmbajnë barrë administrative shqyrtohen në kontekst të parandalimit të barrës administrative në përputhje me metodologjinë për zvogëlimin e barrës administrative*.¹² Afati për përfundimin e këtij treguesi është 30 qershori 2025, sidoqoftë, në këtë raport do të jepen rezultatet deri më 31 dhjetor 2024. Plani i Rritjes është miratuar me datën 9 tetor 2024. Prandaj, matja e treguesit është bërë që nga mbledhja e parë pas mbledhjes së 9 tetorit, e tutje nga zyrtarët e Zyrës për Planifikim Strategjik.¹³

Për këtë qëllim, tabela e mëposhtme do të ofroj rezultatet vetëm për ato ligje të cilat janë miratuara nga data 23 tetor e tutje kur është mbajtur mbledhja e parë pas miratimit të Agjendës së Reformave, deri me 31 dhjetor 2024.

Të miratuara në Qeveri pas datës 9 tetor	Të shqyrtuara para miratimit në Qeveri	Relevante për BA	Numri i komenteve të dhëna	Numri i komenteve të adresuara	Të miratuara në Kuvend	Numri i shërbimeve të thjeshtuara
16	16	1	7	3	0	2

⁹ Shih Shtojcën 3.

¹⁰ Për një konfirmim të ligjeve të miratuara, shih linkun në ZKM: <https://lds.rks-gov.net/Statistics/NrOfApprovedDraftLaës?ministryId=&year=2024>.

¹¹ Shih shtojcën 4.

¹² Shih Agjendën e Reformave në linkun <https://kryeministri.rks-gov.net/agjenda-e-reformave-te-kosoves-irree/>

¹³ Gjatë vitit 2025, nuk ka asnjë ligj të miratuar tjetër, për shkak të përfundimit të rregullt të mandatit të Qeverisë, në respektim të nenit 31 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë.

Pra, evidenca në këtë tabelë dhe në shtojcën 4, evidenton se treguesi është arritur 100%.¹⁴ Në shtojcë janë dhënë edhe datat e aprovimeve, numrat e vendimeve, linçet e publikimeve dhe informacione të tjera, që evidenca të jetë e ndjekshme lehtë, pasi që linku në ueb të ZKM, i ligjeve të miratuara për vitin 2024 nuk jep detaje, por vetëm titujt e ligjeve të miratuara dhe ndarjet në ministri.¹⁵

Projektligjet e shqyrtuara gjatë vitit 2024 në pritje të miratimit nga Qeveria¹⁶

Të shqyrtuara	Relevante për BA	Numri i komenteve në pritje
19	8	138

Përgjatë vitit 2024, janë shqyrtuar edhe 19 projektligje të tjera, të cilat janë në proces dhe nuk janë të miratuara në Qeveri. Prej 19 të shqyrtuarave, 8 janë relevante për barrë administrative, në të cilat janë dhënë 138 komente të nevojshme në dispozitat përkatëse ligjore. Matjet tjera do të bëhen kur të miratohet në Qeveri dhe në Kuvend. Duhet theksuar se këtu nuk hyjnë 2 ligje, të cilat nuk janë komentuar, mirëpo janë duke u hartuar vetëm për procesin e barrës administrative. Pra, në këto raste mund të konsiderojmë se kemi 100% adresim.

Aktet nënligjore¹⁷

Sikurse te aktet ligjore, po ashtu edhe te ato nënligjore procesi ka filluar në gjysmën e dytë të vitit 2023. Duhet pasur parasysh se aktet nënligjore përbëjnë janë numër më i madh se sa i akteve ligjore, përmbajnë më shumë barrë administrative, si dhe është më vështirë të mbahet nën kontroll procesi gjatë gjithë kohës, për shkak të dinamikës së madhe të punës hartuese gjatë tërë vitit.

Për këtë qëllim, ZPZ ka kontrolluar aktet nënligjore të cilat kanë ardhur gjatë konsultimit paraprak, publik dhe disa prej tyre edhe gjatë hartimit, që nga gjysma e dytë e vitit 2023. Një numër aktesh nënligjore janë miratuar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, mirëpo ato kanë qenë të hartuara apo kanë kryer konsultimet në gjysmën e parë të vitit 2023, apo edhe më herët. Për këtë arsye, nuk kanë qenë pjesë e kontrollit për parandalim dhe zvogëlim të barrës administrative.

Siç shihet në tabelën e ofruar më poshtë, gjatë vitit 2023 dhe 2024, janë shqyrtuar në total 160 akte nënligjore, 45 prej të cilave në vitin 2023 dhe 125 në vitin 2024. Prej tyre, 57 kanë qenë relevante për BA, ndërsa 113 jo. Nga 57 relevante për BA, 20 sosh janë hartuar nga ekipi i BA me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit të BA, ku 10 prej tyre janë miratuar më 2024. Në aktet nënligjore relevante për BA të cilat janë komentuar (37 sosh) janë ofruar 175 komente, prej të cilave 29 janë adresuar. Nga të gjitha këto komente të adresuara dhe akte nënligjore të hartuara posaçërisht për BA, janë thjeshtuar 66 shërbime. Duhet theksuar se po ashtu, se 78 akte nënligjore janë në proces, të cilat priten të miratohen gjatë vitit 2025. Në këto akte nënligjore në proces, janë ofruar 215 komente, nga të cilat priten të thjeshtohen më shumë se 50 shërbime të tjera.

¹⁴ Shih edhe raportin e monitorimit të shoqërisë civile, <https://reform-monitor.org/kosovo-reform-agenda-update-pilot-reform-monitor/>, fq. 5 dhe 10, ku konfirmohet arritja e këtij treguesi, në bazë të hulumtimeve të tyre me të drejtën e qasjes publike.

¹⁵ Shih <https://lds.rks-gov.net/Statistics/NrOfApprovedDraftLaes?ministryId=&year=2024>.

¹⁶ Shih shtojcën 5.

¹⁷ Shih shtojcën 6.

Viti	Të shqyrtuara	Të miratuara nga totali	Në proces nga totali	Relevante për BA nga totali	Jo relevante për BA nga totali	Numri i komenteve të dhëna në aktet e miratuara	Numri i komenteve të adresuara në aktet e miratuara	Numri i akteve nënligjore të hartuara posaçërisht për BA të miratuara	Numri i akteve nënligjore të hartuara posaçërisht për BA në proces	Numri i shërbimeve të thjeshtuara pas hyrjes në fuqi	Numri i komenteve në pritje në aktet nënligjore ende në proces
2023	45	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
2024	125	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Total	170	92	78	57	113	175	29	10	10	66	215

Zvogëlimi

Zvogëlimi i barrës administrative është fokusuar në nivel qendror dhe lokal duke përfshirë fazën përgatitore dhe fazën operative për thjeshtim dhe digjitalizim të shërbimeve. Përgatitja për thjeshtim dhe digjitalizim të shërbimeve përfshinë analizimin e legjislacionit dhe gjendjes rregullatore, duke propozuar rekomandimet e nevojshme për intervenim. Po ashtu, analizimi i gjendjes aktuale të kornizës digjitale dhe si ajo duhet të zhvillohet, nëpërmjet metodës “Si është, si të jetë” (AS IS, TO BE). Më poshtë do të përmbledhen proceset kryesore të punës gjatë 2022-2024, për të cilat janë ndërmarrë një numër mjaft i madh aktivitetesh.

Thjeshtimi i shërbimeve në nivel qendror

Në këtë pjesë do të vendosen proceset kryesore të ndërmarra për thjeshtimin direkt apo mbështetës e shërbimeve në nivel qendror. Sidoqoftë, këtu nuk përfshihet shqyrtimi apo hartimi i akteve ligjore apo nënligjore, pasi që të njëjtat janë përmendur te pjesa e parandalimit. Sidoqoftë, shih raportin 2022-2023, në shtojcat 1 dhe 2, për të parë thjeshtimin e 49 shërbimeve në nivel qendror për vitin 2022 dhe 2023, si dhe shih shtojcën 6, rubrikën “Shërbimet e thjeshtuara” për të parë 66 shërbimet e thjeshtuara në vitin 2024.¹⁸

1. Zhvillimi i katalogut të shërbimeve në nivel qendror;
2. Analiza e nevojave dhe përvojave të tatimpaguesve lidhur me komunikimin dhe shërbimet e ofruara nga ATK;
3. Zhvillimi i metodologjisë për shërbimet që mund të ofrohen në mënyrë digjitale e për të cilat nuk ka nevojë nënshkrimi elektronik;
4. Zhvillimi i konceptit për përditësimin dhe modernizimin e ofrimin e shërbimeve për klientë në ATK;
5. Analiza për thjeshtimin e lejimeve që ofrohen nga organet e pavarura: AAC, KPM, ZRRE, BQK, ARRH, KPMM, ARKEP dhe ARRU;
6. Zhvillimi i Udhëzuesit për Informim Publik për Inspektime;
7. Zhvillimi i tre (3) Udhëzuesve për Inspektime: 1) Për kërkesat e detyrueshme të të dhënave për regjistrimin e inspektimeve dhe raportimin në nivele të ndryshme brenda sistemit të inspektoratit, 2) përditësimi i listave të kontrollit dhe 3) inspektimet e përbashkëta;
8. Zhvillimi i Analizës për Vlerësimin e Ndikimit të Inspektimeve Rregullatore në Bizneset Kosovare;
9. Zhvillimi i Udhëzuesit për hartimin dhe zbatimin e mekanizmave të ankesave për kërkesat dhe ankesat e inspektimit të palëve të treta, me qëllim të promovimit të inspektimeve të shkaktuara nga palët e treta;
10. Analiza e detajuar ligjore dhe e proceseve sipas metodës “AS IS, TO BE” për leje ndërtimore të kategorisë 1, 2 dhe 3;
11. Specifikacionet teknike për digjitalizimin e plotë të lejes ndërtimore të kategorisë 1, 2 dhe 3;
12. Koncepti rreth thjeshtimit të shërbimit të pajisjes me letërnjoftim për qytetarët e Kosovës;
13. Analiza për aplikimin e Direktivës për Shërbime të BE për shërbimet ligjore dhe shërbimeve që ndërlidhen me patentë shofer;
14. Analiza për gjendjen aktuale rregullatore të Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve (OAI) në fushën e ndërtimit;
15. Zhvillimi i analizës ligjore për integrimin e POS në ofrimin e shërbimeve;
16. Zhvillimi i analizës së 100 lejeve dhe licencave për largimin e rilicencimit bazuar në rrezik dhe kapacitete të inspektorateve.

¹⁸ Shih Raportin për vitin 2022-2023 te linku: <chrome-extension://efaidnbmnnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/01/RAPORTI-I-ZBATIMIT-TE-PROGRAMIT-PER-PARANDALIMIN-DHE-ZVOGELIMIN-E-BARRES-1.pdf>

Thjeshtimi i shërbimeve në nivel lokal

Sa i përket thjeshtimit të shërbimeve komunale, duhet theksuar se intervenimi është më i kufizuar, për shkak të **kompetencave vetanake të komunës** por edhe për shkak të gatishmërisë së ulët për ndryshim, si në komuna ashtu edhe në nivel qendror kur ky i fundit mund të ketë ndikim. Për këtë qëllim, është vendosur treguesi i barrës administrative në Grantin e Performancës Komunale, në mënyrë që të nxitet thjeshtimi në nivel lokal. Kjo ka pasur një sukses të jashtëzakonshëm, duke thjeshtuar mbi 400 shërbime në 20 komuna, për një periudhë jashtëzakonisht të shkurtër.

Prandaj, më poshtë do të ofrojmë disa prej proceseve kryesore dhe tabelën e thjeshtimit në të gjitha komunat.

1. *Përgatitja e konceptit dhe metodologjisë për thjeshtimin e shërbimeve në komuna;*
2. *Zhvillimi i katalogut të shërbimeve në nivel lokal;*
3. *Analiza për thjeshtimin e shërbimeve në komunën e Ferizajt;*
4. *Zbatimi i rekomandimeve të dala nga analiza për thjeshtimin e shërbimeve në Komunën e Ferizajt;*
5. *Analiza për thjeshtimin e shërbimeve në komunën e Pejës;*
6. *Zbatimi i rekomandimeve të dala nga analiza për thjeshtimin e shërbimeve në Komunën e Pejës;*
7. *Analiza për thjeshtimin e shërbimeve në komunën e Podujevës;*
8. *Analiza për thjeshtimin e shërbimeve në komunën e Suharekës;*
9. *Analiza për thjeshtimin e shërbimeve në komunën e Rahovecit;*
10. *Analiza për thjeshtimin e shërbimeve në komunën e Dragashit;*
11. *Analiza për thjeshtimin e shërbimeve në komunën e Obiliqit;*
12. *Vendosja e treguesit për barrën administrative në Grantin e Performancës Komunale;*
13. *Hartimi i draft rregullores për taksa komunale në funksion të unifikimit të shërbimeve dhe pagesave administrative;*
14. *Zhvillimi i rubrikës E-Komunat brenda platformës E-Kosova.*

Sa i përket thjeshtimeve në nivel lokal në të gjitha statistikatat, ofrohen në tabelën si më poshtë:

Nr.	Komuna	Zbatimi i Grantit të Performances Komunale	Viti	Data e vendimit	Numri i shërbimeve të thjeshtuara me eliminim të dokumenteve	Numri i shërbimeve të thjeshtuara me ulje të pagesave administrative	Numri i shërbimeve të eliminuara	Totali për Komunë
-----	--------	--	------	-----------------	--	--	----------------------------------	-------------------

1	Kaçanik	PO	2024	9 dhjetor 2024	30	0	0	30
2	Junik	PO	2024	9 dhjetor 2024	41	0	0	41
3	Rahovec	PO	2024	12 dhjetor 2024	35	0	2	37
4	Viti	PO	2024	9 dhjetor 2024	3	0	0	3
5	Dragash	PO	2024	10 dhjetor 2024	32	0	6	38
6	Prizren	JO ¹⁹	2022	7 korrik 2022	0	37	25	62
		PO	2024	12 dhjetor 2024	38	0	2	40
7	Gjilan	PO	2024	17 dhjetor 2024	22	0	0	22
8	Mitrovicë Veriore	PO	2024	17 dhjetor 2024	10	0	0	10
9	Deçan	PO	2024	13 dhjetor 2024	20	0	0	20
10	Lipjan	PO	2024	17 dhjetor 2024	30	0	0	30
11	Malisheve	PO	2024	17 dhjetor 2024	10	0	0	10
12	Shtime	PO	2024	26 dhjetor 2024	20	0	0	20
13	Mitrovicë Jugore	PO	2024	17 dhjetor 2024	10	0	0	10
14	Kamenicë	PO	2024	18 dhjetor 2024	10	0	1	11
15	Istog	PO	2024	11 dhjetor 2024	39	0	11	50
16	Podujevë	PO	2024	19 dhjetor 2024	8	0	7	15
17	Obiliq	PO	2024	19 dhjetor 2024	15	0	9	24
18	Drenas	PO	2024	23 dhjetor 2024	20	0	0	20
19	Fushë Kosovë	PO	2024	24 dhjetor 2024	29	0	0	29
20	Peje	JO ²⁰	2023	31 tetor 2023	0	16	13	29
		PO	2024	21 dhjetor 2024	22	0	0	22
21	Ferizaj	JO ²¹	2022	6 mars 2022	0	50	26	76
22	Klinë	PO	2024	26 dhjetor 2024	0	13	0	13

Digjitalizimi i shërbimeve

Në kuadër të kësaj pjesë do ta paraqesim proceset kryesore që janë zhvilluar në kuadër të digjitalizimit. Sidoqoftë, në kuadër të proceseve të digjitalizimit janë ndërmarrë një numër i lartë aktivitetesh të ndryshme, duke përfshirë fazat kryesore para digjitalizimit, si prototipet digjitale, analizat ligjore, përfshirja e përdoruesve në testim dhe ekspozimi në eKosova.

¹⁹ Shih Shtojcën 3 të Raportit 2022-2023.

²⁰ Shih Shtojcën 5 të Raportit 2022-2023.

²¹ Shih Shtojcën 4 të Raportit 2022-2024.

1. Analiza dhe vlerësimi i infrastrukturës digjitale në administratën qendrore;
2. Analiza dhe vlerësimi i arkitekturës së ndërveprueshmërisë digjitale të administratës qendrore;
3. Analiza dhe vlerësimi i legjislacionit për digjitalizim në administratën qendrore;
4. Metodologjia për gatishmërinë institucionale për digjitalizim dhe priorizim të shërbimeve;
5. Analiza dhe vlerësimi i gatishmërisë së ministrive për digjitalizim;
6. Identifikimi dhe analizimi i regjistrave qendror elektronik dhe shërbimeve GG;
7. Mjeti për priorizimin e shërbimeve për digjitalizim;
8. Analiza “AS IS, TO BE” e shërbimeve të MASHT, MINT, ARRH, ARKEP, MD, AKPPM, MSH dhe MMPHI;
9. Analiza e detajuar “AS IS, TO BE” për noterizimin digjital;
10. Zhvillimi i aplikacionit për Qendrën e Thirrjeve të ATK-së për menaxhimin e thirrjeve hyrëse nga tatimpaguesit;
11. Zhvillimi i konceptit për thjeshtimin dhe digjitalizimin e shërbimeve të punësimit;
12. Zhvillimi i Portalit të Raportimit dhe Llogaridhënies dhe Regjistrit të Furnitorëve në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;
13. Thjeshtimi dhe digjitalizimi i shërbimeve për subvencione dhe grante në MKRS;
14. Zhvillimi i analizës AS IS TO BE për 150 shërbime të nivelit qendror dhe zhvillimi final i API për 45 prej tyre (27 në AUV dhe 18 në Dogana, të cilat janë të gatshme për integrim në eKosova);
15. Studimi i fizibilitetit për digjitalizimin e procesit të prokurimit publik.

Proceset e digjitalizimit të cilat janë përfunduar apo në proces deri në dhjetor 2024, janë si më poshtë:

1. Shërbimet e profesioneve të lira (<https://ekosova.rks-gov.net/Service/49>)
2. Shërbimet e licencimit të gjeodetëve (<https://ekosova.rks-gov.net/Service/13>)
3. Shërbimet e licencimit të auto shkollave dhe shërbimeve tjera mbështetëse;
4. Shërbimet e njohjes së diplomave;
5. Shërbimet për licencimin e arkitektëve dhe ingjnierëve
6. Shërbimet për licencimet e Odës së Mjekëve, Odës së Infermierëve, Odës së Stomatologëve dhe Odës së Farmacistëve;
7. Shërbimet e punësimit në APRK
8. Shërbimet për pajisje dhe produkte medicinale (Barnatari);
9. Shërbimet për grante dhe subvencione në MKRS;
10. Shërbimet për grante dhe subvencione në ABGJ;
11. Shërbimi i rezidencës tatimore në ATK;
12. Shërbimet e Qendrës së Thirrjeve të ATK-së për menaxhimin e thirrjeve hyrëse nga tatimpaguesit;
13. Shërbimi i regjistrimit të furnitorëve në MFPT;
14. Portali i Transparencës në MFPT;
15. Sistemi për Menaxhimin e Lëndëve në AIP;

16. Zhvillimi i aplikacionit digjital i Modelit të Kostimit Standard dhe Mbulimit të Kostos;

17. Zhvillimi i Ankandit Online per Agjencinë per Administrimin e Pasurisë se Sekuestruar e te Konfiskuar.

Për të gjitha këto shërbime të zhvilluar apo në zhvillim janë ndjekur disa kriteret, si analizimi i frekuencës dhe popullacionit, analiza ligjore dhe ndryshimi i saj nëse ka qenë i nevojshëm, prototipi digjital, testimi dhe konsultimi i palëve apo përfshirja e përdoruesve, testimi me zyrtarë, trajnimi i zyrtarëve për përdorim dhe ekspozimi në eKosova.

5 Bashkëpunimi

Bashkëpunimi me palët e treta për zbatimin e Programit është një nga aspektet kyçe për arritjen e rezultateve. Në këtë aspekt, ZPS ka zgjeruar bashkëpunimin për zbatimin e Programit me partner të ndryshëm zhvillimorë, shoqërinë civile, odat e biznesit dhe partnerët e huaj strategjik të fushës. Sa i përket bashkëpunimit më shoqërinë civile, qasja e re e Programit orientoi bashkëpunimin nga **avokimi për zbatim në zbatimin e vet Programit**.

Sa i përket bashkëpunimit me odat e biznesit, qasja e re e Programit orientoi bashkëpunimin me to, në drejtim të afrimit të anëtarësisë së tyre në dizajnimin e politikave publike nëpërmjet zbatimit të parimit të personalizimit dhe metodës së bashkë-dizajnit.

Sa i përket bashkëpunimit me partnerët e huaj strategjik, si me OECD/SIGMA, E-Governance Academy, etj., është shtuar bashkëpunimi, nëpërmjet përfshirjes së tyre, **jo vetëm në këshillim por edhe në zbatim të aktiviteteve të ndryshme**, siç është rasti i Kampeve Digjitale, konferencën regjionale për barrë administrative, apo aspekteve të tjera të fokusuara në këshillim dhe orientim strategjik.

Aktivitetet e mëposhtme janë realizuar së bashku me partnerë të jashtëm, organizata të shoqërisë civile dhe oda të biznesit.

- *Mbajtja e Kampit të Parë Digjital për ngritjen e kapaciteteve të shërbyesve civilë me njohuri për digjitalizimin dhe inteligjencën artificiale;*
- *Vizita studimore në Estoni për konferencën e organizuar nga E-Governance Academy me titull "Digitalization as Catalyst for Social Change";*
- *Mbajtja e takimit me shoqërinë civile dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për digjitalizimin e aplikimit për subvencione dhe grante;*
- *Zhvillimi i konceptit për bashkëpunimin me odat e bizneseve në kontekst të barrës administrative;*
- *Analiza për ofrimin e shërbimeve të orientuara kah përdoruesi në Kosovë;*
- *Analiza mbi ndikimin e digjitalizimit të shërbimeve të gjendjes civile në të hyrat buxhetore të komunave;*
- *Mbajtja e takimeve me anëtarësinë e odave të biznesit për barrën administrative të shkaktuar nga inspektimet;*
- *Mbajtja e takimit me shoqëri civile, odat e bizneseve dhe bizneset për barrën administrative në Administratën Tatimore të Kosovës dhe taksimin digjital;*
- *Mbajtja e takimit me shoqëri civile dhe institucionet relevante për zvogëlimin e barrës administrative për Regjistrimin e Automjeteve, Vazhdimin e Regjistrimit dhe Ndërrimin e Pronësisë;*
- *Analizimi i tre "ngjarjeve jetësore" për jetesën, studimin dhe punësimin në Kosovë, në kuadër Single Digital Gateway në Ballkanin Perëndimor;*
- *Vizita studimore në Mbretëri të Bashkuar për konferencën e "Prosperity & Protection - effective regulation for growth, trade and innovation;*
- *Mbajtja e takimeve me OJQ për sfidat për barrë administrative në nivelin lokal;*
- *Mbajtja e takimeve me ATK dhe biznese për zbatimin e Programit në ATK;*
- *Mbajtja e takimit me OJQ dhe institucione për përshpejtimin e procesit të akreditimit të profesioneve të reja dhe rregullimi i standardeve të profesioneve në Kosovë;*
- *Mbajtja e takimit me CIVIKOS dhe OJQ për barrën administrative në Komunitet e Kosovës;*
- *Mbajtja e dy takimeve me OJQ dhe institucione për digjitalizimin e kredencialeve të edukimit si parakusht për zvogëlimin e barrës administrative;*
- *Mbajtja e takimit me biznese dhe institucione për barrën administrative në lejet e ndërtimit;*

- *Mbajtja e takimit me ojq dhe biznese për barrën administrative në regjistrimin e pronës;*
- *Analiza e shërbimeve në terren nëpërmjet Mystery Shopping në komunat e Prishtinës, Gjakovës dhe Ferizaj, për regjistrimin e parë të automjeteve, vazhdimin e regjistrimit dhe ndryshimin e pronësisë;*
- *Mbajtja e konferencës rajonale për barrën administrative, me theks të veçantë në rolin e shoqërisë civile dhe zyrtarëve publikë në zvogëlimin e barrës administrative;*
- *Analiza për shërbimet e MMPHI dhe KPMM për identifikimin e mundësive për thjeshtim të procedurave;*
- *Mbajtja e takimeve konsultative më hisedarë të ndryshëm të ndërmjetësuar nga shoqëria civile;*
- *Analiza mbi Qeverisjes Efikase dhe Vlerësimi i shërbimeve në Kosovë;*
- *Analiza mbi Shërbimet e fokusuara në përdoruesin në Kosovë.*

SHTOJCA 1: Lista e Koncept Dokumenteve relevante për barrë administrative të shqyrtuara para miratimit në Qeveri për vitin 2024

Nr.	Koncept Dokumenti/Dokumenti Strategjik	Institucioni propozues	Miratuar në Qeveri (PO/JO)	Linku i publikimit	Relevant për BA	Numri i komenteve të dhëna	Numri i komenteve të adresuara nga institucioni	Natyra e komenteve të adresuara
1	Koncept Dokument për Fushën e Zejtarisë	MINT	PO	https://kryeministri.rks-gov.net/blog/koncept-dokumenti-per-fushen-e-zejtarise/	PO	14	14	Janë adresuar të gjitha komentet e ofruara, përfshirë sa i takon definimit të problemit, objektivave, opsioneve, ndikimit, planeve si dhe monitorimit. GP ka qenë shumë bashkëpunues, dhe shumë komente janë adresuar së bashku me GP.
2	KD për trajtimin e legjislacionit në fushën e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.	MFT	PO	https://kryeministri.rks-gov.net/blog/koncept-dokument-pyor-trajtimin-e-fushes-se-parandalimit-te-pastrimit-te-parave-dhe-luftimin-e-financimit-te-terrorizmit/	PO	3	3	Komentet janë adresuar sa i përket reflektimit të BA në hyrje të KD-së, tek ndikimet dhe opsionet. Adresimi i komenteve është i pjesërishëm, edhe pse fillimisht janë ofruar komente për intervenime, pastaj ka pasur takim me GP, si dhe janë ofruar edhe propozime për adresimin e komenteve të ofruara.
3	KD për peshkatari dhe akuakulturë	MBPZHRR	PO	https://kryeministri.rks-gov.net/blog/koncept-dokumenti-per-peshkatari-dhe-akuakulture/	PO	21	21	Janë përfshirë të gjitha inputet e ofruara, përfshirë në definimin e problemit, objektivave, opsioneve, planit dhe monitorimit.
4	KD për produktet për mbrojtjen e bimëve	MBPZHRR	PO	https://kryeministri.rks-gov.net/blog/projekt-koncept-dokumenti-pe-produktet-per-mbrojtjen-e-bimeve-pmb/	PO	13	13	Janë adresuar shumica e komenteve të ofruara, përfshira sa i takon definimit të problemit, objektivave, opsioneve dhe planit.

5	KD për Farëra	M B P Z H R	P O	https://kryeministri.rks-gov.net/blog/koncept-dokumenti-per-farerat/	P O	10	10	Teksti i draft KD-së dhe teksti i KD-së së miratuar, ka ndryshuar në aspekte kyçe sic është definimi i problemit, andaj komentet për këtë segment nuk janë reflektuar në versionin e miratuar. Komentet sa i takon objektivave janë reflektuar, kurse ato për opsionet jo. Në anën tjetër janë reflektuar pjesërisht komentet sa i takon ndikimit në BA, si dhe planet. Duhet pasë parasysh që teksti për planet për opsionet ka ndryshuar në masë të madhe.
6	KD për Kooperativat	M B P Z H R	P O	https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2024/08/Koncept-Dokumenti-per-Kooperativat-Bujqesore.pdf	J O			
7	Koncept Dokument për Transportin e Mallrave të Rrezikshme	M M P H I	P O	https://kryeministri.rks-gov.net/blog/koncept-dokumenti-ne-fushen-e-mallrave-te-rrezikshme/	P O	10	10	Janë integruar shumica e komenteve dhe inputeve që janë ofruar për këtë KD, sidomos sa i takon ofrimit të shërbimeve. Megjithatë, nuk janë adresuar komentet sa i takon obligimeve tjera për informacion, sa i takon barrës administrative.
8	Koncept dokument në fushën e Aviacionit Civil	M M P H I	P O	https://kryeministri.rks-gov.net/blog/koncept-dokumenti-ne-fushen-e-aviacionit-civil/	J O			
9	Koncept Dokument për Veprimtari Shkencore dhe Inovacion	M A S H T I	P O	https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2024/07/KONCEPT-DOKUMENT-PER-VEPRIMTARI-KERKIMORE-Copy.pdf	P O	7	7	Janë adresuar të gjitha komentet e ofruara, përfshirë rreth problemit, objektivave por edhe opsionet dhe planit.
10	Koncept Dokument për Bujqësi Organike	M B P Z H R	P O	https://kryeministri.rks-gov.net/blog/koncept-dokumenti-per-menaxhimin-e-integruar-te-mbeturinave/	P O	11	11	Janë integruar shumica e komenteve dhe inputeve që janë ofruar për këtë KD, sidomos sa i takon ofrimit të shërbimeve. Megjithatë, nuk janë adresuar komentet sa i takon obligimeve tjera për informacion, sa i takon barrës administrative.
11	Koncept Dokument rreth Ndhimës Juridike Falas	M D	P O	https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2024/09/Koncept-Dokumenti-per-Ndihme-Juridike-Falas.pdf	P O	0	0	Nuk janë adresuar komentet e ofruara. Nuk ka pasur mundësi të kontaktit me zyrtarët përgjegjës, përkundër një numri përpjekjesh, dhe ofrimit të inputit.
12	Koncept Dokumenti për Fushën e Qeverisjes dhe Menaxhimit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional në Republikën e Kosovës	M A S H T I	P O	https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2024/09/Koncept-Dokumenti-per-Fushen-e-Qeverisjes-dhe-Menaxhimit-te-Arsimit-dhe-Aftesimit-Profesional-ne-Republiken-e-Kosoves.pdf	P O	7	7	Janë adresuar të gjitha komentet e ofruara, përfshirë rreth problemit, objektivave por edhe opsionet dhe planit.

13	Koncept Dokument për Zhvillimin e Kornizës Rregullatore për Tregjet Financiare	M F P T	P O	https://kryeministri.rks-gov.net/blog/koncept-dokument-per-zhvillimin-e-kornizes-rregullatore-per-tregjet-financiare/	P O			
14	Koncept Dokument për Metrologjinë	M I N T	P O	https://kryeministri.rks-gov.net/blog/koncept-dokument-per-metrologjine/	P O			

SHTOJCA 2: Lista e akteve ligjore të shqyrtuara para miratimit në Qeveri në kontekst të parandalimit të barrës administrative për vitin 2023

Nr.	Akti ligjor i shqyrtuar	Institucioni propozues	Është shqyrtuar (1), Nuk është shqyrtuar (2)	Është relevant për BA (1), Nuk është relevant për BA (2)	Është komentuar në kontekst të BA (1), Është hartuar në kontekst të BA (2)	Është miratuar në Qeveri	Viti i miratimit në Qeveri	Data e miratimit në Qeveri	Referenca e Vendimit të Qeverisë	Linku i vendimit të Qeverisë	Linku i publikimit të projektligjit në Qeveri	Numri i komenteve të dhëna/ofruara	Numri i komenteve të adresuara nga institucioni	Natyra e komenteve të adresuara nga institucioni	Numri i shërbimeve të thjeshtuara	Shërbimet e thjeshtuara
1	Projektligji i Sportit	M K R S	1	1	1	P O	2 0 2 3	13 dhjetor 2023	N r. 0 7 / 1 7 8	https://kryeministri.rks-gov.net/blog/vendi-met-e-mbledhjes-se-178-te-te-qeverise/	https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/Projektligji-per-Sport.pdf	10	5	Natyra e komenteve të dhëna në këtë projektligj ndërlidhet me ndarjen e kompetencës lëndore në mes të MPB dhe MKRS gjatë regjistrimit të federatës sportive, eliminimin e kushteve të dyfishta ligjore për regjistrim dhe eliminimin e dëshmisë së	1	Regjistrimi i federatës së sportit

														regjistrimit si OJQ ose si biznes.		
